

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit K.B. nga Prishtina , për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.B., av. B.E., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.616/15 datë 15.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.07.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.B., av.B.E. kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.616/15 datë 15.05.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.616/15 datë 15.05.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin K.B., për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, do ti zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës së pa paguar do ti llogaritet një ditë burgimi. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konform nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPRK-së konfiskohet pistoleta “Reck model-PP” të kal. 9mm me gas me nr. serik M-171064”, prodhim gjerman.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit K.B. av. B.E., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ti marri parasysh të gjitha rrethanat posaçërisht lehtësuese dhe ndaj të mbrojturit të tij të zbus dënimin , e me çka do të arrihej edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.311/2017 të dt. 30.06.2017 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa e mbrojtësit të akuzuarit e që ka të bëjë me lartësinë e dënimit është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por thekson se gjykata i ka dhënë rëndësi shumë të vogël rrethanave lehtësuese krahasuar me rëndësinë e tyre reale siç është pranimi i fajësisë, sjellja korrekte, keqardhja dhe pendimi i sinqertë. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë :si pranimin e fajësisë të cilin e ka vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e thellë të tij, moshën e ti te re dhe në mungesë të rrethanave rënduese, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.322/17, më 14.07.2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____